



**IPA, Programi Ndër-Kufitar MAL I ZI – KOSOVË**  
**(Alokimi për vitet 2011, 2012 dhe 2013.)**  
**Referenca e publikimit: EuropeAid/ 135-345/X/ACT/Multi**

**Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe**  
**Delegacioni i Bashkimit Evropian në Mal të Zi**  
në bashkëpunim me  
**Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe**  
**Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Integritimit Evropian të Malit të Zi**  
shpallin

**Ftesën e Parë për Propozime për Programin Ndër-Kufitar Mal i Zi – Kosovë në kuadër të Instrumentit për Ndihmë Para-Anëtarësimin (IPA) me qëllim që të mbështesë:**

Objektivi i përgjithshëm i programit është përmirësimi i zhvillimit socio-ekonomik i zonës së Programit duke nxitur bashkëpunimin dhe nismat e përbashkëta, ndërsa objektivat e veçanta të Programit janë si në vijim:

- Mbrojtja e biodiversitetit dhe promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore në zonën e Programit;
- Zhvillimi ekonomik i zonës së Programit me një theks të veçantë në dy sektorë prioritarë: a) Bujqësia dhe pylltaria e qëndrueshme; b) Zhvillimi i ofertës turistike e cila plotëson turizmin ekzistuese bregdetar në Mal të Zi. Ky objektiv mund të përfshijë edhe projekte infrastrukturore me qëllim për të lehtësuar bashkëpunimin dhe tregtinë në kuadër të zonës së Programit (p.sh. përmirësimi i pikave kufitare; riparimi i rrugëve);
- Promovimi i kohezionit socio-ekonomik në mes të komuniteteve që jetojnë në rajonet kufitare përmes nxitjes së bashkëpunimit ndër-komunal dhe përmes zhvillimit të partneriteteve dhe rrjeteve në mes të organizatave të shoqërisë civile (OSHC-ve), organizatave profesionale (dmth. dhomave të tregtisë, ndërmarrësve dhe organizatave të bujqve) dhe institucioneve arsimore.

Në kuadër të Ftesës për Propozime, shuma indikative prej 3.240.000 € (1.620.000 € për Kosovën dhe 1.620.000 € për Malin e Zi) është në dispozicion për projekt-propozime të cilat përfshijnë bashkëpunimin ndërkufitar midis banorëve nga zona e programit të Kosovës (territori përfitues i Programit i cili përfshinë rajonin ekonomik perëndimor dhe territori fqinjë i Programit i cili përfshinë rajonin ekonomik verior) si dhe 10 komuna në Mal të Zi (Andrijeviça, Berane, Bijelo Polje, Kolašin, Mojkovac, Rožaje si territore përfituese të Programit, dhe Podgorica, Ulqini dhe Bari si territore fqinje të Programit).

Ditët informuese dhe forumet për kërkimin e partnerëve do të mbahet si në vijim:

Kosovë	16 Janar 2014	Pejë në ora 10:00	Hotel Dukagjini, "Sheshi i Dëshmorëve" – 2, 3000 Peja
	21 Janar 2014	Mitrovicë në ora 10:00	Hotel Palace, Shupkocv - Mitrovicw
Mali i Zi	18 Dhjetor 2013	Beran në ora 10:00	Qendra për Kulturë, Miloša Mališića 11
	20 Dhjetor 2013	Podgoricë në ora 10:00	Fakulteti për Administratë dhe studime Evropiane, Hall A1, Vaka Đurovića bb (stadioni i Buduqnostit)
	22 Janar 2014	Rozhajë në ora 10:00	Do të konfirmohet në webfaqe
	30 Janar 2014	Bari në ora 10:00	Do të konfirmohet në webfaqe

Udhëzimet e plota për aplikues si dhe dokumentacioni tjetër i nevojshëm mund të gjenden në faqen e internetit:

<https://webgate.ec.europa.eu/europeaid/online-services/index.cfm?ADSSChck=1387182840477&do=publi.detPUB&searchtype=QS&orderby=upd&orderbyad=Desc&nbPubliList=15&page=1&aoref=135345;>

[www.mapl.rks-gov.net;](http://www.mapl.rks-gov.net;)

[www.mvpei.gov.me](http://www.mvpei.gov.me)

Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është data **25 mars 2014, ora 16:00 (CET).**

